# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
# "SEVOL" SHPK

- **Mario Kola**, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 18.03.1998, me kartë identiteti me nr.personal J80318050N;

i angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë **06.09.2024**, shpreh vullnetin e tij të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

**1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.**

Emri i shoqërisë do të jetë **"Sevol" SHPK**, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

**2. Ortakët e shoqërisë.**

Ortakët e shoqërisë janë:

- **Mario Kola**, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 18.03.1998, me kartë identiteti me nr.personal J80318050N;
- **Klaudio Çurmaku**, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastër, më datë 02.11.1994, me kartë identiteti me nr.personal J41102060B;
- **Erald Skura**, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel, më datë 30.10.1994, me kartë identiteti me nr.personal J41030037M;

## 3. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

*Objekti i veprimtarië do të jetë:*

***Projektime dhe studime urbanistike: projektime e ndërtime civile, industriale turistike, bujqësore: studime ambientale dhe Vlerësim të ndikimit në mjedis: projektime interierësh: Projektim Peizazhi e sistemimi: studime e projektime elektrike, energjitike, hidrogjeologjik dhe gjeologjike: projektime rrugësh, Urash, porte turistike: projektime të inxhinierisë elektrike, të inxhinierisë hidro-mekanike: projektime konstruktive dhe supervizion punimesh: restaurime. Si dhe konsulenca për temat e me sipërme. Veprimtari në fushën e pasurive të paluajtshme, blerjes, shitjes, investimit dhe zhvillimit të tyre, duke përfshirë këtu qendrat tregtare, banesa të përbashkëta, ndërtesat me apartamente, ndërtesat në bashkëpronësi ose individuale, st dhe zhvillimin e trojeve të pazhvilluara me ose pa ndërtim në to.***

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

## 4. Selia e shoqërisë.

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga Abdi Toptani, Torre Drin Shopping Center, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. **Kohëzgjatja e shoqërisë.**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. **Kapitali themeltar.**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100,00 (njëqind) lekë.**
- Kapitali ndahet në **3 (tre) pjesë/kuota**.

  - Ortaku, **Mario Kola**, zotëron **33%** të kapitalit themeltar, me vlerë nominale **33,00 ALL (njqind) lekë.**
  - Ortaku, **Klaudio Çurmaku,** zotëron **33%** të kapitalit themeltar, me vlerë nominale **33,00 ALL (njqind) lekë.**
  - Ortaku, **Erald Skura,** zotëron **34%** të kapitalit themeltar, me vlerë nominale **34,00 ALL (njqind) lekë.**

7. **Organet vendimmarrëse të shoqërisë.**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. **Administratori**

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

- Administratori i parë shoqërisë do të jetë:

- *Z. Mario Kola*

**9. Likuidimi i shoqërisë**

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**ORTAK**

**MARIO KOLA**

Mario Kola

**KLAUDIO ÇURMAKU**

Klaudio Curmaku

**ERALD SKURA**

ERALD SKURA